

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			
Nr. i prot.	2023/ZDP/101		
Br. prot./Prot. Nr.			
Faqe: 7	Kopje: -	Datë: 30/03/2023	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in.....	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/Interno/Internal.....	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Priština/Pristina	

03/ZDP/VE/2023
Datë: 30 mars 2023

Në mbështetje të nenit 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 30, dt 05 shtator 2022) nenit 24 Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt 01 mars 2019) dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) 05/2019,

Duke u mbështetur në Vendimin nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31.05.2019, Vendimin nr. 24/ZDP/VE/2019 dt. 31.07.2019, Vendimin nr. 26/ZDP/VE/2019 dt. 30 shtator 2019, Vendimin 03/ZDP/VE/2020 dt. 30.03.2020, 09/ZDP/VE/2020 dt. 29.09.2020, 05/ZDP/VE/2021 dt. 30 mars 2021, 04/ZDP/VE/2022 dt. 30 mars 2022, për vazhdim të përkohshëm të aprovimit të operatorit të ANP "Adem Jashari"- LKIA sh.a., si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

- VAZHDOHET** deri më 31 mars 2024, aprovimi i Operatorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – LKIA sh.a. si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10, të shtojcës 1 të Rregullores Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, të ndryshuar.
- OBLIGOHET** subjekti nga pika 1 e këtij vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve t'iu përmbahet me përpikëri dispozitave të Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 dhe akteve tjera normative në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi nga data 01 prill 2023.

ARSYETIM

Më datën 16 prill 2019, operatori i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – LKIA sh.a., ka aplikuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vazhdim të aprovimit si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 të shtojcës 1 të Rregullores Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, me ndryshime.

Nga data e aplikimit deri më tani janë lëshuar për operatorin LKIA sh.a., aprovimet për zgjatje të përkohshme përmes vendimeve si në vijim: Vendimi nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31 maj 2019, Vendimi nr. 24/ZDP/VE/2019 dt. 31 korrik 2019, Vendimi nr. 26/ZDP/VE/2019 dt. 30 shtator 2019, Vendimi 03/ZDP/VE/2020 dt. 30 mars 2020, 09/ZDP/VE/2020 dt. 29 shtator 2020, 05/ZDP/VE/2021 dt. 30 mars

26.

2021 dhe 04/ZDP/VE/2022 dt. 30 mars 2022. Vendimet e lartpërmendura për zgjatje të përkohshme të aprovimit për LKIA sh.a. janë lëshuar me qëllim që organi menaxhues i aeroportit të krijoj kushtet për hapje të tregut në përputhje me kërkesat rregullatore të parapara në Rregulloren 04/2011, të ndryshuar. Gjatë periudhës së vazhdimit të aprovimeve, nga organi menaxhues i ANP “Adem Jashari” është kërkuar krijimi i listës së infrastrukturës së centralizuar për shërbimet në tokë dhe çmimoret përkatëse, si parakushte për krijim e rrethanave për hapjen e tregut për shërbime në tokë për palë të treta.

Më dt. dt. 14 mars 2023, Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar konfirmin nga Departamenti i Aerodromeve se operatori është subjekt i mbikëqyrjes së rregullt nga departamenti i aerodromeve, bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes së sigurisë (annual safety oversight plan) dhe se rrjedhimisht, subjekti në fjalë nuk ka të hapur asnjë mospërputhshmëri lidhur me përmbushjen e kërkesave rregullatore të sigurisë. Kurse, më datë 17 mars 2023 Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar konfirmin nga departamenti i Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit se operatori ka mirëmbajtur gjatë gjithë kohës kriteret ekonomike në baze të të cilave është aprovuar.

Mos zbatimimi i kërkesave ligjore nga LKIA për publikimin e listës së infrastrukturës së centralizuar për shërbimet në tokë dhe çmimoret përkatëse, si parakushte për krijim e rrethanave për hapjen e tregut për shërbime në tokë për palë të treta të parapara në Rregulloren 04/2011, kufizon rolin e AAC si rregullator ekonomik i shërbyeseve në tokë.

Vazhdimi i kohëzgjatjes edhe për një (1) vit bëhet me qëllim të interesit publik të ofrimit të shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 (të shtojcës 1 të Rregullores) dhe krijim të kushteve për zbatim të normave rregullative në fuqi.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, me ndryshime, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me Rregulloren nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC), 05/2019, dhe Vendimeve paraprake për vazhdim të përkohshëm të aprovimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.



Iu dërgohet:

- Organit menaxhues të ANP “Adem Jashari” LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Komitetin për Partneritet Publiko Privat;
- Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat;
- Departamentit për Aerodrome;
- Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit;
- Arkivit të AAC-së.